FIQ
Forumi per Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives

2014

RAPORT VJETOR

FIQ
Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives

RAPORT VJETOR

Për ne

FIQ është fondacion kombëtar filantropik me një traditë të gjatë të punës me komunitetin. Misioni i FIQ-it është zhvillimi i qëndrueshëm me qëllim nxitjen dhe zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve lokale në harmoni me ambientin dhe pa kompromentuar të ardhmen e gjeneratave të ardhshme.

FIQ është themeluar në vitin 2000 nga një grup të rinjsh të vullnetshëm dhe me përkushtim për mobilizimin e qytetarëve për të qënë aktiv në procese vendimmarrëse pas luftës në Kosovë në vitet 1998-1999.

Fillesat e punës së FIQ kanë qënë ato të një organizate të përqëndruar në çështjet e sigurisë dhe të aktivizmit qytetar. Por në suazën e ndryshimeve politike dhe ekonomike të Kosovës dhe me aftësinë e adaptimit ndaj situatave të reja, FIQ po zhvillohet duke u transformuar në një fondacion kombëtar filantropik, i cili eksploron rolin e filantropisë në fusha që forcojnë pjesëmarrjen e qytetarëve, siç janë Zhvillimi i Qëndrueshëm, Dhënie Grantesh.

Ky raporti vjetor ju fton të informoheni rreth angazhimeve serioze të FIQ përgjatë vitit 2014.

Letra e Drejtores Ekzekutive

Të dashur miq,

FIQ është një fondacion komunitar filantropik, që punon me qytetarët për të zhvilluar komunitetet lokale nëpërmjet dhënies së granteve dhe mobilizimit qytetar.

Jemi krenar, që me punën tonë ndihmojmë dhe përkrahim komunitete të ndryshme në Kosovë që të shprehin brengat dhe preokupimet e tyre lidhur me situatën politike, ekonomike dhe sociale, por njëherazi punojmë dhe për identifikimin e të rinjve të talentuar, me ide, dëshirë, vullnet dhe përkushtim për të sjellë ndryshimet e nevojshme në Kosovë.

Viti 2014, shënon fillimin e transformimit programatik të FIQ në një fondacion, që nxit komunitetet të identifikojnë dhe mobilizojnë kapacitetet e veta njerëzore, financiare dhe materiale me qëllim për t'i vënë ato në shërbim të vetvetes dhe të ardhmes së tyre.

Projektet që FIQ mbështetë nëpërmjet Programit të Granteve synojnë që të arrijnë rezultate konkrete në komunitete, e ndërsa procesi që çon në mbështetjen dhe implementimin e këtyre projekteve, krijon, përmirëson ndjeshëm raportet ndërmjet komuniteteve (si kolektivitet) dhe qytetarëve (individë).

FIQ, vlerëson bashkëpunimin me shumë partnerë lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllimin final rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendim marrje dhe në procese që afektojnë jetën e gjithsecilit prej nesh.

- FIQ me kënaqësi e ndan me ju suksesin e mbledhjes së 33 mijë nënshkrimeve në veç 4 ditë, në kuadër të peticionit të koalicionit të organizatave joqeveritare, qytetarëve konsumatorë dhe sindikatave, të cilat së bashku kundërshtojnë rritjen e çmimit të rrymës dhe mungesën e transparencës në sektorin e energjisë.
- FIQ konsideron si një sukses profesional, ndërkombëtarizimin e zhvendosjes së pothuajse 7,000 qytetarëve të Hades prej tokave të tyre në mënyrë abuzive me të drejtat e njeriut dhe standardet e brendshme operacionale të Bankës Botërore.
- FIQ krenohet me punën dhe suksesin në promovimin e ndërrmarrësisë sociale, inovacionit, ruajtjes së vlerave tradicionale dhe promovimit të pasurisë dhe vlerave kombëtare nëpërmjet "Biznes planeve – ideve të gjelbërta" për të tretin vit.

Duke ju falenderuar për kohën dhe vëmendjen tuaj, ju ftoj që të lexoni dhe të përditësoheni rreth punës tonë në faqen tonë www.fiq-fci.org

Miqësisht
Dajana Berisha
Drejtore Ekzekutive

FIQ, promovon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet nxitjes dhe përkrahjes së ndërrmarrësisë sociale në Kosovë

“SaPunë” - projekti që përmes FIQ - it përfitoi grantin prej 10,000 dollarësh

Në vitin 2013, FIQ për herë të dytë hapi konkursin për biznes idetë e gjelbërta dhe inovative, që më tutje bizneset fituese morën pjesë në garën rajonale. Një ndër fituesit e çmimit prej 10.000 dollarëve amerikan ishte projekti “SaPunë”, realizuar nga organizata “The Ideas Partnership”. Me anë të këtij fondi, “SaPunë” rriti biznesin, që tashmë funksionon si biznes social.

Deri tash, 17 gra prej komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Fushë Kosovë dhe Istog janë trajnuar dhe punësuar në këtë biznes social. Regjistrimi i fëmijëve të tyre nëpër shkolla është një ndër kushtet kryesore për përfshirjen e grave në projekt. Deri sot mbi 200 fëmijë të këtyre komuniteteve përmes këtij projekti janë rikthyer në shkollë. Të arriturat e këtij projekti janë shumëdimensionale, që nga përfshirja e grave të këtyre komuniteteve, punësimi dhe përfitimi i tyre nga projekti, vazhdimi i shkollimit të fëmijëve të tyre, sensibilizimi i publikut për rëndësinë e gjësendeve që prodhohen nga materialet e ripërdorshme, siç është rasti i çantave që zëvendësojnë qeset e plastikës, përfitimi edukativ-arsimor i grave të mësojnë shkrim-lexim, aktivitete që mbahen nga vullnetarët e organizatës, dhe poashtu përfitimi i nga pesë familjeve të ndryshme të komuniteteve që çdo javë marrin veshmbathje të dorës së dytë.

FIQ, vazhdon të ndihmojë në realizimin e projektit, shitjen e produkteve dhe marketingun e biznesit “SaPunë”.

FIQ mobilizon bizneset vendore për të ndarë një donacion me poça elektrik efiçient në fshatin Grackë e Vogël në Lipjan

Mobilizimi i bizneseve vendore në efiçiencën e energjisë por jo vetëm, është një kërkesë e domosdoshme e kohës, që ndihmon të siguroj pjesëmarrje të komuniteteve në identifikimin e nevojave, por njëherazi dhe në rritjen e bashkëpunimit me bizneset vendore.

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) ka zhvilluar një aktivitet komunitar në fshatin Grackë e Vogël, Lipjan duke dhuruar poça eklektrik efiçient për 69 shtëpi të këtij fshati. Ky donacion është mundësuar nga bashkëpunimi i FIQ me dy biznese vendore nga Prishtina, "Elen" dhe "Aurora", të cilët kanë ndarë donacionin prej mbi 500 poça, në vlerë prej 1,750 euro.
Ky aktivitet ka patur si qëllim promovimin e përdorimit të pajisjeve efiçiente për shfrytëzimin efikas dhe kursimin e energjisë elektrike. Në aksion përveç stafit të FIQ, kanë marrë pjesë edhe stafi i dy kompanive donatore, si dhe aktivistët e Këshillit të Fshatit Grackë e Vogël.

Banorët kanë mirëpritur aktivitetin, duke shprehur poashtu brengën për faturat e larta të energjisë elektrike. Ky aktivitet është vetëm një pjesë e punës tanimë katërvjeçare që FIQ realizon në kuadër të KOSID-it, për mobilizimin dhe përfshirjen e biznesit vendor në promovimin e efiçiencës së energjisë.

FIQ promovon inovacionin, rëndësinë e ekonomisë së gjelbërt nëpërmjet organizimit për çdo vit të garës rajonale për ide të gjelbëra dhe inovative

Tre finalistët e Kosovës morrën pjesë në garën rajonale për biznes ide të gjelbërta dhe inovative **"Filantropia për ide të gjelbërta"**, e cila u mbajt në Shqipëri.

Inventa – biznes kreativ, udhëhequr nga 18 vjeçarja Rita Aliti, e cila përkundër moshës së re, ka arritur sukses në prodhimin e më shumë se 500 modeleve të bizhuterive nga materiale të ricklueshme dhe shitjen e tyre përmes rrjeteve sociale, duke përfshirë në biznes poashtu të rinj me sindromën down.

Ekoart – biznesi tjetër tërësisht me materiale të ricklueshme, me shishe, letra dhe gazeta krijojnë vepra arti dhe si i tillë përmban elemente inovative dhe unike.

Biznesi i tretë pjesëmarrës nga Kosova në garën rajonale konsiston në riciklimin e plastikave dhe letrës, me mbledhjen dhe riciklimin e të cilave krijohen vende pune për komunitetin RAE në Fushë Kosovë.

Pjesëmarrësit nga Kosova, arritën të zgjerojnë rrjetin e tyre profesional, duke shkëmbyer përvoja me pjesëmarrësit nga pesë vendet e Ballkanit. FIQ do të vazhdoj të përkrahë finalistët nga Kosova, në mënyrë që bizneset e tyre të rriten, të gjenerojnë më shumë punësim dhe të hyra më të mëdha, njejtë siç bëri vitin e kaluar me projektin "Sa Punë".

Situata në sektorin e energjisë vazhdon të mbetet kaotike duke reflektuar kësisoj mungesë vizioni zhvillimor afatgjatë, të qëndrueshëm dhe Europian për Kosovën.

Mbi 33.000 nënshkrime nga qytetarët në peticionin kundër ngritjes së çmimit të rrymës janë veç një ndër mekanizmat me anë të të cilëve FIQ solli në vemendjen e Kuvendit të Kosovës dhe Presidentes pajtueshmërinë se gjendja ekonomike dhe sociale në vend është tejët e rënduar!

Në shtator 2014, si pjesë e punës brenda KOSID, FIQ bashkë me organizata partnere nëpër komuna, ka organizuar një peticion në 22 komuna të Kosovës, me qëllim të mbledhjes së nënshkrimeve të qytetarëve në një nismë legjislative (peticion) kundër rritjes së çmimeve të energjisë elektrike. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në Kosovë ka rritur tarifat me pakicë të energjisë elektrike dy herë brenda 2014, duke shtuar më tej barrën e qytetarëve të Kosovës të cilët nuk mund të përballojnë rritje të vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike për shkak të gjendjes së dobët socio-ekonomik. KOSID bashkë me mbi 70 organizata të shoqërisë civile, organizata të konsumatorëve, si dhe sindikatat e punëtorëve, u mblodhën për të avokuar për një iniciativë legjislative kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike, ku FIQ mori përgjegjësinë e organizimit të peticionit në gjithë Kosovën dhe arriti të mbledhë mbi 33.000 nënshkrime nga qytetarët në të gjithë vendin, në mënyrë që të paraqesë kërkesën për Kuvendin e Kosovës.

Më 20 janar 2015, peticioni i është dorëzuar Kuvendit, përkatësisht Komisionit Parlamentar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione. Ndonëse rrugëtimi i peticionit ka përfunduar nëpër dyert e komisioneve parlamentare pa u paraqitur në Kuvend për t'u votuar prej parlamentarëve, çështja e rritjes së çmimit të rrymës u bë tema kryesore e protestave paqësore qytetare që ndodhën në Kosovë, më 18 prill 2015.

Për të gjetur përgjigjen, apo formulën e duhur ndaj situatës së vështirë ekonomike dhe pasigurisë politike, që tashmë ka kapluar Kosovën, kërkohet pjesëmarrje, bashkëpunim dhe qasje gjithëpërfshirëse

FIQ eksploron dhe promovon bashkëpunimin filantropik ndër-sektorial gjatë Javës së Filantropisë

Si një ndër programet themelore të FIQ Programi i Filantropisë synon, të jetësoj trekëndëshin e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve më të rëndësishëm të shoqërisë dhe pikërisht sektorit publik, sektorit privat dhe sektorit civil, me qëllim përfshirjen e të gjithë shoqërisë kosovare në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, përkundër modelit aktual jo të qëndrueshëm dhe me polarizim e fragmentarizim të shoqërisë sonë.
"Java e Filantropisë" e cila do të shndërrohet në një traditë të përvitshme në Kosovë u karakterizua me aktivitete të ndryshme, duke filluar me koktejin e organizuar enkas për gazetarë, për t'i falenderuar ata për bashkëpunimin gjatë vitit 2014.
Në këtë koktej, gazetarët ndoqën dokumentarin e shkurtër të realizuar nga FIQ, që i dedikohet filantropisë në Kosovë. Ndërkohë që, pas dokumentarit, ata patën rastin të votojnë për punimin më të mirë nga studentë të Fakultetit të Arteve në Prishtinë, punim ky, që u shpërblye nga FIQ me një shumë modeste prej 200 eurosh për fituesin.

Ekspozita përmbante 10 punime nga 10 studentë të pikturës, dizajnit grafik dhe fotografisë dhe që secila nga to shprehte diçka rreth filantropisë.

Pjesë kryesore e Javës së Filantropisë, qe konferenca me titull **"Papunësia e të rinjve dhe iniciativat filantropike për krijimin e mundësive për ta**", e ndarë në dy sesione interesante si "Papunësia e të rinjve një çështje kritike – A po i ofrojmë të ardhme të rinjve në Kosovë", dhe "Arti, edukimi, kultura - këta kontribues të mëdhenj të transformimeve të rëndësishme shoqërore".

Konferenca ia doli të provokonte një debat kritik mbi rëndësinë e angazhimit të të gjithë akterëve në adresimin e çështjes së papunësisë së të rinjve në Kosovë. Panelistët dhe pjesëmarrësit nga lëmenj të ndryshëm patën rastin të diskutojnë temën e papunësisë në një dimension tjetër, tejët interesant sipas tyre, pasi panelistët dhe audienca përfaqësonte sektorë si ai privat, sektorin akademik, sektorin e shoqërisë civile dhe ndërrmarrës të rinj.

Hafiz Leka, Kryesues i Divizionit për punësim në Departamentin për punë dhe punësim, Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale: - Nuk ka statistika reale në Kosovë. Varfëria është e lartë ndoshta më e larta në rajon. Në vitin 2013 janë regjistruar rreth 268.104 të papunë.

Drejtori Ekzekutiv i Institutit GAP, Agron Demi, deklaroi, se '60.000 studentë në vit diplomohen duke formuar kështu një forcë të kualifikuar punëtore, por pa qasje në tregun e punës. Ndërkohë që 96.000 është shifra e të punësuarve në sektorin public, duke e shndërruar këtë të fundit në punëdhënësin më të madh në vend."

Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e Forumit për Iniciativa qytetare (FIQ), tha se aktualisht migrimi është një nga problemet më kritike të vendit. Ajo përmendi disa statistika, sipas të cilave, numri i të papunëve në Kosovë është më i larti në rajon, 55.9 për qind. Berisha theksoi se për pasojë, të rinjtë nuk po shohin të ardhme dhe se kjo është një nga shkaqet kryesore të migrimit.

Paneli i dytë i konferencës u karakterizua me diskutimet mbi ndikimin e artit, edukimit dhe kulturës, si kontribues të transformimeve të rëndësishme shoqërore. Veç tjerash, pothuajse të gjithë panelistët u pajtuan, se adresimi i papunësisë së të rinjëve duhet bërë bashkërisht nga sektori publik, ai privat dhe shoqëria civile.
"Vlera e patjetërsueshme e artit, kulturës konsiston në aftësinë për të mobilizuar një numër të madh qytetarësh, në informim dhe edukim duke mos lënë mënjanë dhe rritjen e kultivimin e imazhit të Kosovës" – Eroll Bilibani, Dokufest

Punëtoria me fëmijë të kategorive të ndryshme sociale

Aktiviteti i fëmijëve kishte për qëllim promovimin e filantropisë (në konceptin e solidaritetit, komunikimit, punës në grup për një çështje të përbashkët) në mesin e fëmijëve. Pesë institucione të kategorive të ndryshme sociale si: Shoqata Down Syndrome Kosova, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Çerdhja Ardhmëria, The Ideas Partnership, dhe Shoqata Autizmi, ishin pjesëmarrës të realizimit të këtij aktiviteti tejët interesant, që u realizua në dy punëtori. E para kishte për qëllim punimin e kartolinave për festat e fundvitit, të cilat FIQ do t'ua dërgoj gjatë vitit 2015 bizneseve të ndryshme në Kosovë, ku fëmijët poashtu shprehën dëshirat e tyre për dhurata. Në punëtorinë e dytë fëmijët vallëzuan në bashkëpunim me shkollën "Dancing Ballroom."

Simpozium për Filantropi

Tre ide të reja të natyrës së biznesit social të identifikuara prej stafit të FIQ, përmes punës në terren, u prezantuan para rreth 20 bizneseve si kërkesë për mbështetje dhe bashkëpunim të mundshëm. Idetë e reja të bizneseve sociale, të cilat FIQ i përzgjodhi për t'i prezantuar para bizneseve ekzistuese, pritet të realizohen në vitin 2015 dhe të mbështeten nga po këto biznese që morrën pjesë në simpozium.

Ceremonia e ndarjes së Çmimit FIDES 2014 për Filantropi

Haki Abazi, Drejtor i Fondit të Vëllezërve Rockefeller u shpreh, se: RBF është i nderuar dhe i privilegjuar që ka mundësinë të punojë me Forumin për Iniciativa Qytetare dhe e konsideron atë si një partner strategjik!

FIDES është një ngjarje tradicionale, që ka pronësinë e FIQ dhe që mëton të nxjerrë në pah vlerat e filantropisë kosovare. Duke shprehur mirënjohje publikisht ndaj filantropëve individë, apo kompanive vendore dhe ato të diasporës, FIQ ka ndërtuar një sistem vlerash, i cili vit pas viti njeh rritje të kontributeve, të pjesëmarrjes dhe cilësisë së investimeve. Filantropia si dashuri për njerëzimin, solidaritet për njeri-tjetrin ka nevojë të ushqehet e të promovohet si vlerë, andaj dhe FIQ tashmë e ndan Çmimin FIDES për të gjashtin vit me rradhë.

Çmimin FIDES për kontribut në nivel kombëtar e fitoi IPKO Foundation, për kontribut në arsim dhe teknologji informative, ndërkohë që **FIDES për kontribut individual** i shkoi z. Misin Zenunaj nga Klina, i cili ndërtoi qendrën rinore në fshatin Gremnik të Klinës dhe përkrahjen e aktiviteteve tjera rinore.

Çmimin FIDES 2014 për kontribut nga diaspora, e fitoi biznesmeni i suksesshëm z. Lazim Destani, i cili ka ndarë një pjesë të fitimeve të bizneseve të tij për qëllime bamirësie, mbështetje të projekteve kulturore dhe të arsimit, si dhe atyre të ambientit.

Lazim Destani: *"Shumë biznesmenë ka Kosova, si në vend ashtu edhe jashtë. Ne individualisht jemi shumë të suksesshëm, por të bashkuar pak e kemi një defekt, unë besoj t'i bashkojmë forcat me shumë biznesmenë të cilët gjenden jashtë në diasporë, fuqinë e vet qoftë kapitale apo intelektuale të përvojës së tyre t'i bashkojnë dhe t'i sjellin në Kosovë, dhe të punojmë natë e ditë dhe dëshiroj sa më shpejt ta shoh Kosovën në Bashkimin Evropian".*

Çmimin FIDES 2014 për partneritet filantropik e fitoi Komuna Hani i Elezit, me në krye z. Rufki Suma, i cili shquhet për ndërmarrjen e aktiviteteve filantropike dhe përkrahjen e grupeve të ndryshme sociale.

FIDES 2014 për organizata të shoqërisë civile, e fitoi organizata The Ideas Partnership, për përkrahjen e grupeve të margjinalizuara siç janë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, duke krijuar vende pune për gratë e këtij komuniteti dhe përfshirjen e fëmijëve në shkolla.

Këtë natë, u nda edhe një çmim i veçantë, ai për **kontribut jetësor "Hasan Prishtina"**, i cili iu nda Vëllezërve Mikel e Simon Kuzhnini, të cilin e ndau z. Murat Jashari.

Vëllezërit Kuzhnini u nderuan me këtë çmim, për kontribut jetësor që i kanë bërë popullit të Kosovës, duke dhënë nga pasuria e tyre familjare një pjesë të konsiderueshmë të mjeteve financiare dhe kohës.

Me rastin e ndarjes së Çmimit FIDES 2014, Drejtoresha ekzekutive e Forumit për Iniciativa Qytetare, Dajana Berisha, në fjalën e saj tha se: ***Së bashku do të mund të bëjmë edhe më tepër për ata qytetarë që janë në nevojë, duke shtuar se shoqërisë tonë i duhen politikanë që ndjejnë për qytetarët dhe jo ekonomistë mediokër.***

FIQ dhe IAZHL përpilojnë raportin analitik "Shëndeti publik në Obiliq"

FIQ në bashkëpunim me Iniciativën për Ambient dhe Zhvillim Lokal (IAZHL) kanë përpiluar raportin analitik, që ka për qëllim të hedhë dritë mbi gjendjen aktuale të shëndetit publik në Obiliq. Studimi është bazuar në të dhënat zyrtare të ofruara nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Obiliq, për periudhën 2009-2013.

Në Obiliq veprojnë dy termocentralet TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B", të cilat janë shumë të vjetra dhe funksionojnë duke përdorur teknologji të vjetëruar, çka ka rezultuar në një nivel të lartë të ndotjes së ajrit në mjedis, i cili është shkaktuar drejtpërsëdrejti nga emetimi i gazrave nga të dy termocentralet. Rezultatet nga analizat tona tregojnë se në mesin e banorëve të Obiliqit të cilët kanë qenë të diagnostikuar nga QKMF, ekzistojnë tri lloje të sëmundjeve të cilat janë mbizotëruese në mesin e këtij komuniteti: diabeti (41%), sëmundjet kardiovaskulare (24%), dhe sëmundjet mendore (23%). Ky raport analitik ka për qëllim sensibilizimin e akterëve për të parandaluar ndërtimin e një TC të ri në Obiliq.

Avokim për respektimin e standardeve ndërkombëtare të "Zhvendosjes së dhunshme dhe të detyrueshme", pasi zhvendosja e qytetarëve të Hades në kuadër të projektit të termocentralit "Kosova e Re" përbën një ndër dështimet e Bankës Botërore dhe Qeverisë së Kosovës për të respektuar standardet ndërkombëtare të "zhvendosjes së detyrueshme"

Forumi për Iniciativa Qytetare, më 28 qershor organizoi seminarin në Hade të Obiliqit, bazuar në raportin e profesor Ted Downing, president i Rrjetit ndërkombëtar për zhvendosje të detyruar.
Seminari u mbajt nga ekspertët e FIQ, ndihmuar dhe nga organizata lokale IAZHL, e cila ka qenë e përfshirë thellësisht në këtë proces. Në seminar pati një pjesëmarrje të gjerë të komunitetit të Hades.

Qëllimi i këtij seminari ishte informimi i banorëve në lidhje me propozimin e Bankës Botërore dhe Qeverisë së Kosovës në kuadër të projektit të termocentralit "Kosova e Re", me ç'rast u diskutua gjerësisht sesi ky projekt nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare të zhvendosjes, si dhe me rregullat e brendshme të Bankës Botërore rreth zhvendosjes, duke shkaktuar rreziqe të rënda ekonomike, sociale dhe mjedisore të fshatit Hade dhe rrethinës. Gjithashtu u prezantuan në detaje pasojat negative të zhvendosjes mbi banorët si: shpërbërja e sistemeve të prodhimit, reduktimi i të ardhurave, dëmtimi i infrastrukturës së sistemit shkollor dhe përçarjet sociale.
Ndër dështimet kryesore që raporti bën të qartë është a) udhëzimi i gabuar i BB për Qeverinë e Kosovës në raport me zhvendosjen duke sjellë në prodhimin dhe implementimin e "Kornizës për zhvendosje" në vend të një "plani të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës për zhvendosje", b) mbivlerësimi i kapaciteteve institucionale të Qeverisë së Kosovës për të menaxhuar procese komplekse si zhvendosja; c) mungesa e pjesëmarrjes dhe konsultimeve të hollësishme me qytetarët e zhvendosur; dhe mbi te gjitha d) varfërimi i mëtejshëm i qytetarëve të zhvendosur pikërisht prej këtij procesi.

FIQ monitoron konsultimin publik "Projekt Studimi i fushëveprimit mjedisor dhe social (SFMS) për ndërtimin e termocentralit të ri"

Forumi për Iniciativa Qytetare monitoron konsultimin publik të organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planfikimit Mjedisor në bashkëpunim me Komunën e Obiliqit dhe Bankën Botërore si financues i këtij projekti, në kuadër të "Projekt Studimit të fushëveprimit mjedisor dhe social (SFMS) për ndërtimin e termocentralit të ri" Në këtë takim, ku pati një pjesëmarrje të gjerë të banorëve të prekur nga ky projekt, organizatave lokale dhe atyre kombëtare, FIQ paraqiti një raport, i cili përmbante mangësitë dhe mospërputhshmërinë e SFMS me legjislacionin e vendit dhe atë ndërkombëtar.
Ndër të tjera, FIQ propozoi alternativa të tjera për përmirësimin e këtij studimi, duke përfshirë teknologji më të avancuara drejt mbrojtjes së mjedisit.

FIQ informon studentët e Universitetit të Miamit (SHBA) rreth çështjeve të sektorit kritik të energjisë në Kosovë

Kushtrim Puka, Menaxher i Programeve në Forumin për Iniciativa Qytetare (FIQ) iu bashkua studentëve të Miami University, që po vizitonin Kosovën, për të ndarë me ta çështjet që prekin sektorin e energjisë, të mjedisit dhe zhvillimit ekonomik në vend. FIQ ka prezantuar platformën e funksionimit dhe të punës së KOSID (Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm) për efiçiencën e energjisë, promovimin e burimeve alternative të energjisë. Avokimi në nivel të Kosovës dhe ndërkombëtar është pjesë themelore e misionit të FIQ.

Konferenca: Zhvillimi i marrëdhënieve civile-ushtarake në Kosovë

Kjo konferencë e organizuar nga FIQ/Forumi për Siguri, në bashkëpunim me Prof.John De Rosa kishte për qëllim nxitjen e dialogut ndërmjet përfaqësuesve të forcave të armatosura, Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile në kontekstin e transformimeve të vazhdueshme të Forcave të Sigurisë së Kosovës, duke adresuar faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, që formësojnë marrëdhëniet civile-ushtarake si dhe njëherazi të kultivojë një kulturë të komunikimit dhe dialogimit ndërsektorial për çështje që ndërlidhen me sigurinë e Kosoves.

Të rinjtë dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës diskutojnë bashkë

FIQ, në kuadër të projektit "Rock debatet politike me të rinjtë", financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, realizoi debatin paszgjedhor me të rinj të moshës 18-24 vjeç dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.
Diskutimet u përqëndruan më shumë në zhvillimin ekonomik dhe planet e partive politike lidhur me këtë temë, që prek rininë, si pjesë vitale e shoqërisë kosovare. Po ashtu u diskutua për arsimin dhe ndërlidhjen e tij me zhvillimin ekonomik të vendit. Të rinjtë pjesëmarrës ishin kritik lidhur me paqartësinë se në cilët sektorë mund të gjenerohen vende të reja pune, premtim kyç i partive politike.

Ata poashtu patën vërejtje të mëdha për politikat e dobëta arsimore, mos-stimulimin për ndërmarrësinë si pasojë e kamatave të larta bankare, mosnjohja me ligj e punës vullnetare si përvojë e punës, nevojën e orientimit të remitencave në investime dhe tema të tjera të kësaj natyre. Ky debat ishte pjesë përmbyllëse e fushatës së organizuar nga FIQ me moton"Bonja like me 8 qershor", që kishte për qëllim rritjen e numrit të votuesve të rinj në zgjedhjet parlamentare.

SIGN për Qëndrueshmëri
Ekspozimi rajonal i FIQ

Në kuadër të rrjetit rajonal SIGN për Qëndrueshmëri (Rrjeti i Organizatave Grantdhënëse nga Evropa Juglindore), ku bëjnë pjesë organizata nga 6 vende të rajonit, FIQ ka organizuar konsultime online lidhur me standardet minimale të ngritjes së fondeve, si dhe tryezën për të paraqitur dhe diskutuar raportin me rekomandime të politikave në lidhje me ndikimin që kanë ligjet për tatimet, në filantropi në Kosovë. Poashtu, përmes Akademisë për Qëndrueshmëri, FIQ i ka përkrahur 16 OJQ me bazë komunitare në ndërtimin e kapaciteteve të veçanta për ngritje fondesh. FIQ ka mobilizuar OJQ-të vendore me bazë komunitare, bizneset, individët dhe institucionet përkatëse qeveritare, për të diskutuar dhe për të ofruar rekomandime të qarta të politikave sa i përket ligjeve të tatimeve që ndikojnë në filantropi.
FIQ ka publikuar edhe raportin "Regjimi tatimor për filantropi në Kosovë - një propozim për reforma", si dhe ka zhvilluar një hulumtim të opinionit publik lidhur me zhvillimin e filantropisë në Kosovë.

Takime me komunitete në komuna të ndryshme të vendit
Duke vazhduar mbajtjen e lidhjes dhe komunikimit me grupe qytetare, FIQ ka takuar përfaqësues të komuniteteve në Lybeniq të Pejës, Skifteraj dhe Budrikë të Vitisë, Janjevë të Lipjanit, në Vrellë dhe Banjë të Istogut, duke mësuar për aktivizmin qytetar në këto vendbanime dhe ofrimin e përkrahjes sonë për nisma dhe projekte komunitare.
Grantet e FIQ-it për projekte të vogla diverse në tema, komuna dhe problematika synojnë, që nëpërmjet diversitetit të adresojë problemet më të ngutshme dhe njëherazi të ndihmoj idetë që kanë potencial për të sjellë ndryshime dhe për të informuar publikun rreth zhvillimeve më kryesore në Kosovë. Si të tilla fushat/sektorët në të cilat programi i granteve të vogla të FIQ ka kontribuar duke mbështetur ide përfshijnë, mjedisin dhe energjinë, trafikun rrugor, formate të debateve bashkohore, publikime rreth raporteve ndërkombëtare, kulturë etj.

Në kuadër të Programit të Granteve, FIQ ka vazhduar pëkrahjen për të dytin vit me radhë për Iniciativën për Ambient dhe Zhvillim Lokal (IAZHL) në Obiliq. Si organizatë e mobilizimit komunitar, IAZHL ka realizuar aktivitete të drejtpërdrejta me qytetarë në mbrotjen e mjedisit dhe projekteve energjetike. IAZHL ka organizuar takime informuese, debate dhe seminare me banorë të Obiliqit rreth çështjeve me rëndësi në sektorin e energjisë.
Poashtu, kemi financuar fushatën e Policisë së Kosovës "Rrugë të mbarë dhe të sigurt gjatë pushimeve", e cila ka adresuar sigurinë në komunikacion rrugor të bashkëatdhetarëvë tanë nga diaspora, gjatë sezonit veror.

OJQ FLOSSK - Free/Libre Open Source Software ka përfituar nga program ynë i granteve në organizimin e TEDxPrishtina, një format i njohur ndërkombëtar i diskutimeve dhe sjelljes së përvojave të personaliteteve me ndikim në fusha të ndryshme jetësore.

Një projekt tjetër i përkrahur ka qenë botimi i analizës "Konferenca e Dejtonit" e autorit Fidan Kozhani, student i shkencave politike në UP, një studiues entuziast i marrëdhënieve ndërkombëtarë në Ballkan.

FIQ poashtu ka bashkënfinancuar edhe Jazz Festival Prishtina, në edicionin e tij tradicional të promovimit të muzikës jazz, me pjesëmarrje ndërkombëtare.

FIQ gjithashtu ka përkrahur financiarisht Institutin për Kriminologji dhe Kriminalistikë në organizimin e një konference ku është publikuar dhe diskutuar raporti: "Sjelljet në trafikun rrugor".

FIQ dhe partneriteti ndërkombëtar

Eksperienca e gjatë e punës në terren e FIQ-it, e vendos organizatën në një pozitë të çmueshme për të transferuar, ndarë këto eksperienca dhe me partnerë ndërkombëtarë, qofshin këta rajonal, apo përtej rajonit të Ballkanit.
Viti 2014 ka qënë i ngarkuar me angazhime, kontribute të FIQ në një numër eventesh ndërkombëtare. Pjesëmarrja e FIQ në Bruksel, Washington DC, Cleveland në 100 vjetorin e Fondacioneve Filantropike Amerikane, Erste Foundation në Austri, vizita studimore në Suedi, kanë sjellë përfshirjen e FIQ në "Global Foundation", në përfshirjen dhe përfitimin e fondeve rajonale IPA FPA (Kuadri i partneriteteve në kuadër të fondeve të EU IPA), trajnimin e stafit për t'u specializuar në trajnimin e OJQ-ve vendore në Kosovë në fushën e ndërrmarrësisë sociale dhe në hartimin e modelit për efiçiencë të energjisë.

FIQ
Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives

Stafi 2014

Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive

Kushtrim Puka, Menaxher i Programeve: të Filantropisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Nazim Haliti, Menaxher i Programit të Granteve

Sefë Govori, Menaxher i Financave dhe Administratës

Arieta Dragusha, Zyrtare e Programit

Deniza Mulaj, Zyrtare e Programit

Meivis Struga, Zyrtar i Projekteve

Donatorët

Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World
EMBASSY
UNITED STATES OF AMERICA
NED
National Endowment
for Democracy
Supporting freedom around the world

European
Commission
giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
catalyst

FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare
Forum for
Civic Initiatives

Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives

Rr. Sejdi Kryeziu,
Blloku 20 nr 3
10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677
info@fiq-fci.org
www.fiq-fci.org